

KREU I EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1 DATA, EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 **Sot** me date 06.01.2021 eshte themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **"A.S 21 SHPK"** (më poshtë e quajtur "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 1.3 Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Frang Bardhi" , Njesia administrative Nr.5,Godina nr 4. ,kati pare,Prane Qendres Kristal,Tirane.

- 2.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Veprimtarine e Agjentit Komisioner ,per shoqeri vendase ose te huaja. Veprimtarine e konvertimit te monedhes (EXCHANGE). Si dhe veprimtari te tjera te

natyres financiare te lejuara nga ligji. Veprimtari e agjentit per transferte parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke. Veprimtari e agjentit per sherbimin e pagesave per te tretet ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke. Ushtrimi I veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te institucionit financiar jo bank dhe ndermjetesimi I pagesave utilitare (gjoba ,oshee,ukt etj). Agjensi imobiliare, studime tregu, komisioner dhe agjensi per te tretet. Veprimtari ne fushen e biznesit, marketingut dhe konsulences financiare.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1** Kapitali i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 1 (nje) kuote me vlerën 100,000 (njëqind mijë) Lekë, që përfaqësojnë 100% të kapitalit, i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku i Vetëm **Z. Ardi Kostandin Sotiri**, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene me date 25.10.1987 me numer ID I71025021D dhe banuese ne Rrugen "Komuna e parisit ", Tirane , person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETET

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Ortaku i Vetëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një noteri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 7 BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.

KREU III NDRYSHIMI I KAPITALIT

NENI 8

- 8.1** Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Ortakut të Vetëm mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Ortakut të Vetëm apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2** Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 9

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 9.1** Ortaku i Vetëm, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Ortaku i Vetëm, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2** Pas marrjes së një vendimi të tillë, Ortaku i Vetëm cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3** Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, ortaku i vetëm i shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4** Pas marrjes së vendimit të dytë nga Ortaku i Vetëm, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

KREU IV

ORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 10

STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

- 10.1** Shoqëria tregtare "A.S 21 SHPK" ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :
- Ortaku i Vetëm si organi vendimmarrës për shoqërinë;
 - Administratorin

NENI 11

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS

- 11.1** Ortaku i Vetëm, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.2** Ortaku i Vetëm merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës "1" të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
- 11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të ortakut të vetëm. Ortaku i vetëm, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.

- 11.4** Nga ana e Ortakut të Vetëm merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - d) vendimet e marra në zbatim të nenit 9 të këtij statuti.
- 11.5** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12

MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMMARRËS

- 12.1** Mbledhja e Ortakut të Vetëm zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.
- 12.2** Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nga kryesisht nga ortaku i vetëm, administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3** Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4** Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Ortakut të Vetëm. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU V

ORTAKU I VETËM, FINANCIMET

NENI 13 ORTAKU I VETËM

- 13.1** Ortak i Vetëm i Shoqërisë është **Z, Ardi Sotiri** shtetas shqiptarë, lindur në Tepelene, më 25.10.1987, mbajtës i Letërnjoftimit Nr: I71025021D, banues në adresën: Rrugen "Komuna e parisit", Tirane, Shqipëri.

NENI 14 VENDIMET E ORTAKUT TË VETËM

- 14.1** Ortaku i Vetëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.
- 14.2** Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

NENI 15 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT TË VETËM

- 15.1** Të drejtat dhe detyrat e ortakut të vetëm janë:
- Të marrë pjesë në mbledhjet e Ortakut të Vetëm;
 - Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
 - Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspertit kontabël;
 - Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
 - Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

NENI 16 FINANCIMI I SHOQËRISË

- 16.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejte të kërkojë nga ortaku i vetëm i shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2** Financimet e mëtejshme të ortakut në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

KREU VI ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 17 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 17.1** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga ortaku i vetëm për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:
- **Z. Ardi SOTIRI**, shtetas shqiptar, lindur në Tepelene, lindur në Tepelene, më 25.10.1987, mbajtës i Letërnjoftimit Nr: I71025021D, banues në adresën: Rrugen "Komuna e parisit", Tirane, Shqipëri.
- 17.2** Në zbatim të këtij neni, administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organeve të tjera të Shoqërisë.

NENI 18 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

- 18.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) raportojë përpara Ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

NENI 19

PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT

- 19.1** Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 20

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

- 20.1** Ortaku i Vetëm përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU VII

KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 21

KONTROLLI KONTABËL

- 21.1** Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaku i Vetëm do

të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

- 21.2** Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 22 VITI FINANCIAR

- 22.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 23 BILANCI DHE REZERVAT

- 23.1** Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Ortaku i Vetëm të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 23.2** Ortaku i Vetëm vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 23.3** Ortaku i Vetëm në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

NENI 24 PUNËSIMI NË SHOQËRI

- 24.1** Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

KREU VIII PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 25

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 25.1** Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortaku i Vetëm.
- 25.2** Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Ortaku i Vetëm emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Shoqëria prishet në këto raste:
- Kur nuk mund të përmbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
 - Me vullnetin e ortakëve;
 - Me vendim të Gjykatës
 - Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

NENI 26

PROCEDURAT QË NDIQEN

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare "A.S 21 SHPK" vendoset nga Ortaku i Vetëm kur prishet shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 26.3** Në qoftë se Ortaku i Vetëm, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Ortakut të Vetëm zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.

26.5 Në fund të procesit të likuidimit thirret Ortaku i Vetëm për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

NENI 27

NJOFTIMET

27.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.

27.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

27.3 Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU IX

BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË

NENI 28

28.1 Shoqëria "A.S 21 SHPK" me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron te njëjtin aktivitet.

28.2 Gjithashtu shoqëria "A.S 21 SHPK" me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

28.3 Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.

- 28.4** Transferimi i plotë i aktivitetit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Ortaku i Vetëm.

**KREU X
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 29
LIGJI I ZBATUESHËM**

- 29.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjisllacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 30

- 30.1** Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

**ORTAKU I VETËM
I
SHOQËRISË "A.S 21 SHPK"
Z. ARDI SOTIRI**


